

REZISTENCA PAQËSORE DHE INSTITUCIONET PARALELE NË KOSOVË
(1990- 1999) -VËSHTRIM HISTORIK

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER
NGA
DONIKA KROSA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

MARS, 2022

REZISTENCA PAQËSORE DHE INSTITUCIONET PARALELE NË KOSOVË (1990- 1999)- VËSHTRIM HISTORIK

Mentor: Prof. Dr. Bujar Dugolli

Kandidate: Donika Krosa

Dhjetëvjeçari i fundit i shekullit XX në Kosovë, paraqet një periudhë të veçantë politiko-juridike e shoqërore. Përballë hegjemonizmit serb, përkatësisht politikës së Millosheviqit populli shqiptar e ngriti shkallën e organizimit të tyre në një lëvizje shqiptare e cila pasoi valë masive të demonstratave dhe protestave, përmes të cilave kërkohet drejtësi, liri dhe barazi për popullin shqiptar.

Materia e këtij punimi është e përbërë nga katër kapituj, të cilët janë punuar me analizë dhe trajtim të materialeve të disponueshme; libra, artikuj nga shtypi: “Rilindja”, “Bujku”, “Koha Ditore”, “Bota e Re”, dokumente arkivore, buletine etj...

Përgjatë viteve të rezistencës shqiptare u veçuan iniciativa të guximshme, të cilat kulmuan me Protestën e Minatorëve të Trepçës dhe Grevës së tyre, pastaj Apeli i 215 intelektualëve shqiptarë të cilët bënë thirrje për mos ndryshime kushtetuese për krahinën e Kosovës, pa pëlqimin e tyre, Deklarata Kushtetuese e Kuvendit të Kosovës e 2 korrikut 1990, Kushtetuta e Kaçanikut e 7 shtatorit 1990, Referendumi për Kosovën shtet të pavarur dhe Sovran, dhe zgjedhjet e para Parlamentare të Kosovës.

Qëllimi i këtij punimi është t’i paraqesë dhe të analizojë të gjitha këto akte, të cilat synonin krijimin dhe organizimin e institucioneve të Kosovës, që ndikuan në shkëputjen përfundimtare të shqiptarëve nga Serbia.

Si çdo sferë tjetër e jetës në Kosovë, arsimit shqip u përball me politikën diskriminuese të regjimit serb, i cili projektoi planprograme mësimore me qëllim serbizimin e institucioneve të Kosovës, por që nxënësit dhe mësime të shqiptarë nuk pranuan të zbatonin ato programe, me ç’rast u larguan shumë mësime nga puna dhe u shkarkuan nga detyra drejtorë të shkollave duke u zëvendësuar me emra të rinj serb e malazezë. Arsimit në Kosovë ishte një shtyllë e rëndësishme e rezistencës shqiptare dhe e mbijetesës në rrethana të okupimit. Përpjekja e organizimit të mësimin në shtëpi- shkolla u vlerësua në masë të lartë si një akt i cili mundësoi vazhdimësinë e procesit mësimor duke forcuar kështu vetëdijen kombëtare, e që për këtë nuk munguan as sakrificat dhe vështirësitë e shumta nëpër të cilat kalonin nxënësit- studentët dhe profesorët.

Në situatë të njejtë gjendej edhe shëndetësia në Kosovë, mjekët kosovarë të cilët u mundësonin trajtime pacientëve të tyre duke u ballafaquar me rreziqe dhe kërcënime nga ana e okupatorit me shtypje, fushata e presion të paparë. Serbët, pengonin punën e mjekëve dhe kurimin e shqiptarëve, ata u penguan të kryenin punën e tyre edhe në rastin e helmimit të fëmijëve shqiptar, të një kategorie shumë të ndjeshme të shoqërisë, përveç që e mohuan atë.

Një ngjarje shumë fisnike që ka ndodhur në vitet 90' e cila është trajtuar këtu është Pajtimi i Gjaqeve që njihet edhe si Pranvera e Madhe ose Moti i Madh i Shqiptarëve. Kjo fushatë pati ndikuar shumë në bashkimin e shqiptarëve duke kthyer shikimin vetëm kah pushtuesi e jo në ngaterrësat e tyre ndërsqiptare duke eliminuar kështu gjakmarrjen dhe pengimin e zhvillimit të jetëve normale të tyre për shkaqe hasmërie, nganjëherë edhe të pa arsyeshme.

Duke ndjekur politikën e rezistencës paqësore, me qëllim gjithnjë të njejtë u organizuan protesta paqësore nga studentë të Universitetit të Prishtinës por që përfundonin dhunshëm pasi ato shpërndareshin në mënyrë brutale nga policia serbe. Studentët ishin të vendosur në vazhdimin e aktivitetit të tyre me qëllim lirim të objekteve shkollore dhe universitare, kështu ata vazhduan me protesta edhe pas 1 tetorit 1997 dhe gjatë vitit 1998 por më nuk kishte vetëm qëllimin që patën në fillim, studentët u ngritën në protesta edhe kundër dhunës dhe masakrave që ndodhën në Drenicë.

Lëvizja Studentore pati efektet e veta, ajo arriti sensibilizimin e çështjes së Kosovës në nivel vendor e ndërkombëtar. Pas së cilës UPSUP-ja zgjeroi aktivitetet e veta kur situata në Kosovë u keqësua. Të rinjtë e UP-së u solidarizuan edhe me ndihma të ndryshme që i bënë popullsisë civile dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, madje disa prej tyre edhe duke u bërë pjesë e saj.